



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Nr. ____ / ____ Prot.

Tiranë, më.....2020

Lënda: Kthim përgjigje Nr. 184

Zj. FJOALDA RROKAJ

Adresa: Lgj. “Isa Boletini”, Rr. “Mehmet Çiço Petoshati”

Banese Private pranë Pallatit 566

VLORE

Për dijeni:

DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

FIER

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar dy herë me shkresën datë 09.06.2020 protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr. 5527/2 Prot. datë 11.06.2020, dhe shkresën datë 09.06.2020 protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr. 11015 Prot. datë 18.06.2020, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr.184, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Me Vendimin Nr. 351, datë 06.04.2020, në përfundim të procedurës së ristrukturimit, ju jeni liruar nga detyra për shkak të suprimimit të pozicionit të punës. Komisioni i ristrukturimit/punëdhënësi, në shqyrtimin e vazhdueshmërisë së kontratës së punës dhe përputhshmërisë së punonjësit me pozicionet e reja të organizuara është mbështetur në shqyrtimin e ndryshimeve strukturore, sipas organigramës e strukturës së re dhe të vjetër, dosjes personale e të dhënat që disponohen në të dhe përshkrimin e punës.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë zbatuar procedurat në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me e-mailin e datës 14.02.2020 janë bërë me dije nga Titullari i institucionit të gjithë punonjësit e Administratës Tatimore për fillimin e procesit të ristrukturimit, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Me shkresën Nr. 5527 Prot., datë 09.03.2020 ju jeni njoftuar për zhvillimin e takimit me punëdhënësin në lidhje me kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar. Në datë 27.03.2020 jeni paraqitur në takim me punëdhënësin duke firmosur dhe proces-verbalin e mbajtur po në këtë datë.

Përsa i përket pikës 1, 2 lidhur me numrin e punonjësve të cilëve u është zgjidhur kontrata, ju bëjmë me dije se procesi i ristrukturimit nuk ka përfunduar aktualisht dhe për këtë arsye nuk mund të jepet numri definitiv i vakancave apo lëvizjeve të stafit.

Informojmë se Struktura e Re e miratuar me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, përsa i përket pozicioneve të punës të cilat rregullohen nga Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka një reduktim me 72 pozicione pune.

- Përsa i përket pikës 3 ku kërkohen kriteret e veçanta dhe arsimi përkatës të punonjësve aktualë, bazuar në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ndryshuar, si dhe në Ligjin 9887, datë 10.03.2019 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, i ndryshuar, neni 5, “Mbrojtja e të dhënave personale”, neni 6, pika 1, “Kriteret ligjore për përpunim”, të dhënat për arsimin e punonjësve janë të dhëna personale, të cilat nuk mund të bëhen publike pa pëlqimin e subjektit të të dhënave personale.
- Përsa i përket pikave 5,6,7,8, lidhur me pozicionet vakante dhe kriteret e veçanta në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë mund të njiheni me to nëpërmjet faqes zyrtare www.tatime.gov.al, ku janë shpallur pozicionet vakante, së bashku me kriteret e kërkuara për konkurim.
- Përsa i përket pikës 9, bëjmë me dije se nuk ka asnjë pozicion vakant në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier.
- Përsa i përket pikës 10, vënies në dispozicion të urdhrave të punës gjatë periudhës së punësimit ju duhet të drejtohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me të cilën keni patur marrëdhëniet e punës e financiare.

Bashkëlidhur gjeni:

- Shkresën Nr.5527 Prot., datë 09.03.2020 “Njoftim për zhvillimin e takimit me punëdhënësin në lidhje me kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar”
- Proces-verbal datë 27.03.2020
- Vendimin Nr. 351, datë 06.04.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm
- Kontratat individuale të punës

Zv. DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klajd Shuka